Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0987

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "LK Solutions Sh.P.K.", kundër Vendimit për anulim të aktivitetit te projektimit të Qendra Klinike Universitare e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te laurave", me nr. të prokurimit: 701-23-10905-1-2-1, me 14/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "LK Solutions Sh.P.K.", me nr. 2023/987, e datës 06/12/2023, kundër "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", për anulimin e aktivitetit prokurimit me titull: "Furnizim me pajisje te laurave", me nr. të prokurimit: 701-23-10905-1-2-1, AK/ Qendra Klinike Universitare e Kosovës.

2. Anulohet "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues " i datës 22.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje te laurave", me nr. të prokurimit: 701-23-10905-1-2- dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.10.2023 Qendra Klinike Universitare e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me pajisje te laurave", me nr. të prokurimit: 701-23-10905-1-2-1. Ndërsa me datën 22.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 44,090.00 €.

Me 24.11.2023, OE "LK Solutions SH.P.K." ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 29.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "LK Solutions SH.P.K." me nr. 987/23 për lidhur me aktivitetin "Furnizim me pajisje te laurave", me nr. të prokurimit: 701-23-10905-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "LK Solutions SH.P.K." , janë parashtruar si në vijim:

Ne Vendimin e anulimit të AK thuhet "Gjate vlerësimit është vërejtur se ka mospërputhje te sasisë se tiketave te parkingut ku ne ST te detyrueshme figuron kutia prej 5000 cope kurse ne përshkrim te çmimit 3000 cope dhe është ofertuar po me atë sasi. Andaj propozohet anulimi i kësaj procedure te prokurimit" Ne SP fillimisht ka pasur gabime dhe mungese te specifikave, ku ju keni sqaruar me date 25.10.2023 dhe keni vendosur specifika te reja dhe te përmirësuara. Ne SP te dosjes ka pasur mungesë te specifikave për produktet e pozicionit 8 , 9 , 10 , 11 dhe ne sqarim janë vendosur këto specifika qe kane munguar . Gjithashtu ne SP te dosjes pozicioni i 6 është kërkuar Front Panel Plexiglass ndërsa ne sqarim është vendosur Automatic Barriers. Ne pozicionin e 3,4,7 është shënuar vetëm emri produkti pa asnjë specifik, ndërsa ne sqarim është ndërruar produkti i pozicionit 7 dhe janë vendosur specifikacioni. Sipas specifikave te sqarimit te gjitha produktet përputhen me përshkrim te çmimit. Ne pozicionin e 1 te letrës ne specifikat e sqarimit është specifikuar edhe dimensionet e letrës ndërsa nuk është vendosur numri i sasisë. Kutia Standarde te tiketave është 3000 ndërsa ne raste te veçanta kërkohet mbi këtë numër qe nuk preferohet për arsye se kutia ka dimenson standard ndërsa tiketat duhet te shtypen me tepër . Prandaj duke u bazuar ne standarte te kutisë, përshkrimit te çmimit me sasi 3000 dhe pasi qe nuk është vendosur sasia ne sqarim kemi ofertuar sipas përshkrimit te çmimit. Sipas LPP Neni 53 Pika 7 OE obligohet qe te ofertohet sipas sqarimit te ofruar nga AK. Atëherë vlerësimin e tenderit ju si AK e kini bere nga SP te dosjes e jo nga SP te sqarimit, ku sipas SP te dosjes ka mungesë dhe gabime te shumta. Si është bere vlerësimi duke u bazuar ne 2 specifika paralele?. Ne kemi ofertuar sipas specifikave te sqarimit me përpikëri ku edhe përshkrimi i çmimit është i njëjtë. Supozojmë: se anulimi i këtij aktiviteti te prokurimit është në kundërshtim me LPP. Jemi te gatshëm si OE te dorëzojmë kutinë prej 5000 tiketave sipas specifikave te vjetra te dosjes.".

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "LK Solutions SH.P.K", konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me LPP-së. Kërkojmë qe te bëhet rivlerësimi i këtij aktiviteti te prokurimit, duke u bazuar ne sqarimin e specifikave qe ju i keni vendosur ne platformën e prokurimit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 987/2023, ndërsa me datë 18.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/987 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje lidhur me raportin e ekspertit.

Vlerësimi i eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/987, të pretendimeve ankimore të OE ankues, si në vijim;

Sqarim hyrës: "Lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje te laurave", me numër të prokurimit: 701-23-10905-1-2-1, të iniciuar nga AK – Qendra Klinike Universitare e Kosovës. OE ankues: "LK Solutions" sh.p.k. Prishtine, pretendimet ankimore i ka parashtruar kundër njoftimit mbi vendimin e AK-se te datës 22.11.2023, ku AK- QKUK ka propozuar anulimin e procedurës se prokurimit. OE sipas kërkesë për rishqyrtim ka kërkuar rivlerësim te ofertave, ku arsyetimin e eliminimit e ka kundërshtuar me pretendimet se nuk janë respektuar dispozitat ligjore te LPP-se. Me gjithë atë AK QKUK, sipas vendimit ka refuzuar kërkesën dhe ka lënë ne fuqi vendimin e AK-se për anulim e kësaj procedure te prokurimit."

"Eksperti shqyrtues sqaron se AK ne letrën standarde te datës 22.11.2023, kundër OE ankues si arsyetim te eliminimit ka potencuar se "gjate vlerësimit është vërejtur se ka mospërputhje te sasive te tiketave te parkingut ku ne specifikim teknik te detyrueshëm figuron se kuti duhet te këtë 5000 cope, kurse ne përshkrim te çmimeve është 3000 cope dhe është ofertuar me po këtë sasi, prandaj propozohet anulimi i kësaj procedure te prokurimit". Eksperti shqyrtues vlerëson se arsyetimi për anulim te aktivitetit te prokurimit ne fazën pas hapjes, pas vlerësimit madje pas korrigjimit te gabimit dhe sqarimit te specifikave te obligueshme nuk gjen mbështetje ligjore ne dispozitat e ligjit për prokurim publik konkretisht nenit 62 te LPP-se dhe nenit 43 Rregullores Nr.01/2022, paragrafi 43.7 dhe 43.8 përcaktojnë. 43.7 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK. 43.8 Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyet e mëposhtme: a. për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve; b. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; c. është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar, brenda kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP; d. nëse është paraqitur pamundësia e përdorimit të platformës elektronike nga të gjithë përdoruesit si pasoje e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe AK dhe verifikimit e konstatimit nga KRPP-ja. AK-QKUK me datën 25.10.2023, ka publikuar sqarimet lidhur me spacifikacionet teknike te detyrueshme sipas kërkesave te OE-ve ku ka potencuar se specifikimet janë te hartuar thjeshte duke mos detalizuar ne mënyrë qe mos te jen produktet specifike por te ofrohen produkte te ndryshme ne mënyrë qe te jeni kompatibile me pajisjet qe operojnë ne QKUK. Pajisjet duhet te jene sipas specifikimeve te ngjashme apo ekuivalente qe supertohen nga terminalet ekzistues ne mënyrë te qe te finalizohen produktet. Për derisa tek paramasa dhe parallogaria ne pozicionin 1, është kërkuar "tiketa te parkingut kuti (3000 cope)". AK-QKUK para hapjes te ofertave ka nxjerr edhe njoftim mbi korrigjimin e gabimit ku përveç tjerash është kërkuar edhe deklarate për specifikacionet teknike te detyrueshme, ku OE ankues ne oferte ka prezantuar deklaratën e tille, prandaj Eksperti shqyrtues konsideron se arsyetimi i eliminimit bie ndesh edhe me nenin 52 paragrafi 3, përkatësisht nenin 56 paragrafin 3 te LPP-se, ku përcaktohet se: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara

dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit". Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimet ankimore janë te bazuara."

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues vëren se AK ka publikuar sqarime lidhur me spacifikacionet teknike te detyrueshme sipas kërkesave te OE-ve ku ka potencuar se "specifikimet janë të hartuar thjeshte duke mos detajuar ne mënyrë qe mos të jenë produktet specifike por të ofrohen produkte të ndryshme ne mënyrë qe të jen kompatibile me pajisjet që operojnë ne QKUK. Pajisjet duhet të jenë sipas specifikimeve te ngjashme apo ekuivalente që supertohen nga terminalet ekzistues ne mënyrë te qe te finalizohen produktet".

Paneli shqyrtues pa nevoja për sqarime tjera shtesë sqaron se tek paramasa dhe parallogaria në pozicionin 1, është kërkuar "tiketa te parkingut kuti (3000 cope)". AK para hapjes të ofertave ka nxjerr edhe njoftim mbi korrigjimin e gabimit ku përveç tjerash është kërkuar edhe deklarate për specifikacionet teknike te detyrueshme, të cilën OE ankues ne oferte e ka prezantuar andaj për panelin shqyrtues arsyetimi i eliminimit bie ndesh me nenin 52 paragrafi 3, përkatësisht nenin 56 paragrafin 3 te LPP-se, ku përcaktohet se: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Paneli shqyrtues konstaton se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me anulimin e aktivitetit prokurimit, sipas nenit 43.1 i Rregullores për Prokurim Publik nr,01/2022 i cili përcakton "Ne rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të publikoj Formularin B58 "Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues" ku paraqiten arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit të tillë.

Paneli Shqyrtues lidhur me Njoftimin e Autoriteti Kontraktues, datës, 22.11.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit "Furnizim me pajisje të laurave", aktiviteti prokurimit: 701-23-10905-1-2-1, konstaton se AK ne njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, nuk ka shënuar asnjë nga arsyet faktike të anulimit e as nuk ka shënuar bazën ligjore të anulimit dhje kjo është në kundërshtim me neni 43.1 Rregullores për Prokurim Publik, nr.01/2022.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertes shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – QKUK, lidhur me aktivitetin e prokurimit;701-23-10905-1-2-1 dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

Autoriteti kontrakturës obligohet në procesin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit t'i evitojnë të gjitha shkeljet ligjore, lidhur me pretendimet ankimore te OE-së, të cilat janë vlerësuar si të bazuara sipas raportit të ekspertit shqyrtues, përkatësisht dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, dhe nenin 105 nenin të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES**
- OE - **LK Solutions SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: